

20121663949

L I G J
PËR PLOTESIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PEN
SIONAL DHE INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 98/12), në nenin 50 paragrafi (4) pas fjaleve: "ka marre" shtohen fjalet: "të mesem", ndersa pas fjaleve: "mbushjes së" shtohet numri "20".

Neni 2

Pas nenit 247 shtohet nen i ri 247-a, si vijon:

"247-a

(1) Krahas harmonizimit të pensioneve të percaktuar në nenin 37 të këtij ligji, në vitin 2013 të gjitha llojet e pensioneve në pajtim me kete ligj harmonizohen në menyre plotesuese.

(2) Harmonizimi plotesues nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet pasi që shuma e pergjithshme për pagese të pensioneve për muajin shkurt 2013, e llogaritur para harmonizimit sipas nenit 37 të këtij ligji, do të rritet për 5% dhe do të pjesetohet me numrin e pergjithshem të shfrytëzuesve të pensionit, të cilet pensionin e kane realizuar perfundimisht me muajin shkurt 2013."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", pervec nenit 2 që do të filloje të zbatohet nga 1 marsi 2013.